



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 05, datë 19.05.2025

PËR

**“MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS, ELEMENTËVE PËRBËRËS DHE
VLERAT E PAGËS BRUTO MUJORE SI DHE PËRSHKRIMET E PUNËS, TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian	Sala	Kryetar
Z.	Armer	Juka	Anëtar
Z.	Bleron	Dokle	Anëtar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 19 maj 2025 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues, të ndryshuar dhe ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Për miratimin e strukturës dhe organikës, elementët përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.*

BAZA LIGJORE:

1. Pikat 4 dhe 5, gërmat “a” dhe “b” të pikës 6 të nenit 13 të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shpjegues i projektvendimit
2. Projektvendimi i arsyetuar

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Miratimi i strukturës dhe organikës, elementët përbërës dhe vlerat e pages bruto mujore dhe përshkrimet e punës të punonjësve të AKEP, nga Këshilli Drejtues si organ kolegjal përbën një ushtrim të drejtpërdrejtë të kompetencës së njohur shprehimisht me ligj, në funksion të garantimit të autonomisë së plotë të një autoriteti rregullator të pavarur.
2. Projektvendimi është hartuar në referencë të pikave 4 dhe 5, gërmave “a” dhe “b” të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht:

“4. Struktura dhe organika e AKEP-it miratohen nga Këshilli Drejtues. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e AKEP-it rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

“5. Rekrutimi i punonjësve të AKEP-it bëhet në bazë të kërkesave dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion, të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe të përcaktuara në rregullore e brendshme të funksionimit të tij.

“6. Këshilli Drejtues i AKEP-it ndër të tjera, miraton:

- a) *elementët përbërës të pagës bruto mujore të të punësuarve të institucionit;*
- b) *vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të institucionit”.*

3. AKEP, në cilësinë e një autoriteti rregullator të pavarur, ka kompetencë të veçantë ligjore për të përcaktuar organizimin e brendshëm dhe strukturën e personelit, në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.
4. Këshilli Drejtues i AKEP-it është organi përgjegjës për miratimin e elementëve përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore.
5. Këshilli Drejtues i AKEP-it është organi përgjegjës për miratimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion në përputhje me organikën.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikat 4, 5, gërma “a” dhe “b” të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Miratimin e strukturës dhe organikës, elementëve përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, sipas lidhjeve nr. 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala Bako	Armer Juka	Bleron Dokle	Edlira Dvorani	Lorenc